

30711
654

Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve të lartë / që kanë detyrimin për deklarinimin e pasurisë,

Nr	Emer Mbiemer	Funksioni	Arsimi	Kategoria e Pages
1	Ardian Alushi ,(i emeruar me vendim nr. 7 ,date 16.02.2015 .te Komisionit Kombetar te Perzgjedhjes per TND – ne dhe me shkrese nr. 648/7 prot, date 20.02.2015 te Departamentit te Administrates Publike)si nepunes civil i nivelit te larte drejtues, anetar TND- se Kompetencat dhe detyrat e tij dhe procedura që ndjek për të marrë vendime; (shih Rregulloren e DPUK – se , pika 4.2)	Drejtor i Pergjithshem i Drejtorise se Pergjithshme Ujesjelles Kanalizimeve	Inxhinjer DIND	II - a
2	Fejzi Mezin ,(i emeruar me urdher Nr 74,, date 23.01.2014 “Per emerim ne detyre “ te Ministrit te Transportit dhe Infrastruktures Kompetencat dhe detyrat e tij dhe procedura që ndjek për të marrë vendime; (shih Rregulloren e DPUK – se , pika 4.4) i	Zv.Drejtor i Pergjithshem i Drejtorise se Pergjithshme Ujesjelles Kanalizimeve (teknik, Ekonomik)	Inxhinjer DIND	II - b
3	Arben Skenderi ,(i emeruar me urdher Nr 16, date 18.10.201 “Per emerim ne detyre “ te Ministrit te Transportit dhe Infrastruktures Kompetencat dhe detyrat e tij dhe procedura që ndjek për të marrë vendime; (shih Rregulloren e DPUK – se , pika 4.4)	Zv.Drejtor i Pergjithshem i Drejtorise se Pergjithshme Ujesjelles Kanalizimeve / Drejtor i Projekteve te Huaja	Inxhinjer DIND	II - a

ORGANIKA E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME UJËSJELLËS KANALIZIME
Miratur me Urdhërin Nr. 65, datë 06.05.2009

POZICIONI	KATEGORIA	Nr.
Drejt看 i Përgjithshëm	II-a	1
Sekretar		1
ZV/Drejt看 i Përgjithshëm/Drejt看 i Projekteve të Huaja	II-a	1
ZV/Drejt看 i Përgjithshëm	II-b	1
Drejt看ia Teknike		8
Drejt看	III-a	1
Spektori I Kontrollit te Projekteve dhe Makineri Pajisje		
Përgjegjes Sektori	III-a/1	1
Specialist	IV-a	1
Specialist	IV-a	1
Spektori I Programimit		
Përgjegjes Sektori	III-a/1	1
Specialist	IV-a	1
Spektori Juridik dhe I Prokurimeve		
Përgjegjes Sektori	III-b	1
Specialist	IV-a	1
Drejt看ia Ekonomike		8
Drejt看	III-a	1
Spektori i Finances		
Përgjegjes Sektori	III-b	1
Specialist	IV-a	1
Spektori i Investimeve		
Përgjegjes Sektori	III-b	1
Specialist	IV-a	1
Spektori i Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve		
Përgjegjes Sektori	III-b	1
Specialist	IV-b	1
Shofer		1
Drejt看ia e Monitorimit te Projekteve dhe Sh.a.UK-ve		7
Drejt看	III-a	1
Spektori i Monitorimit te Projekteve dhe Faqes se Internetit		
Përgjegjes Sektori	III-a/1	1
Specialist	IV-a	1
Spektori i Monitorimit te Sh.a.UK-ve		
Përgjegjes Sektori	III-a/1	1
Specialist	IV-a	1
Specialist	IV-b	1
Specialist	IV-b	1
Drejt看ia e Projekteve te Huaja		8
Projekti Hidrik dhe Kanalizimet e Tiranës se Madhe		
Koordinator	II-a	1
Specialist	III-b	1
Projekti Ujesjellesi dhe Ujerat e Perdorura, Shkoder dhe Koplik		
Koordinator	II-a	1
Projekte me KFW		
Koordinator	II-a	1
Projekte te Programit IPA		
Koordinator	II-a	1
Specialist	III-b	1
Projekti i Sherbimeve Esenciale		
Koordinator	II-a	1
Projekti i Ujesjellesit te Vlores		
Specialist	III-b	1

Gjithsej : 35 (tridhjetë e pesë) punonjës.

Informacion


Data:23.04.2015.

Tabele e funksioneve ,detyrave dhe kompetencave te drejtoresive/ive arsimit dhe kualifikimet

Nr	Drejtoria /Struktura	Detyrat Funksionale	Arsimi
1	Drejtoria Teknike Drejtore Sektori i Kontrollit te Projekteve dhe Makineri Pajisje Pergjegjes Sektori Specialist Specialist Sektori i Programimit Pergjegjes Sektori Specialist Sektori Juridik dhe i Prokurimeve Pergjegjes Sektori Specialist	Mbulimi i Aktivitetit teknik qe nga Kontrolli Teknik i dokumentacionit te projekteve ,preventivave ,koolaudimi i objekteve si dhe ndjekjen dhe azhurnimin e situates dhe gjendjen e makineri paisje qe kane ne dispozicion nderrmarjet e Ujesjelles Kanalizime.	Drejtore (Inxhinjer Ndertim) DIND
2	Drejtoria Ekonomike Drejtore Sektori i Finances Pergjegjes Sektori Specialist Sektori i Investimeve Pergjegjes Sektori Specialist Sektori i Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve Pergjegjes Sektori Specialist Shofer	Programimi dhe ndjekja e fondeve operative dhe ato te investimeve ne fushen e Ujesjelles Kanalizimeve te Dpuk per objektet e menaxhuara nga DPUK dhe organet e pushtetit Lokal per sigurimin e mbarevajtjes se aktivitetit te DPUK – SE ,ne kuadrin e praktikave dhe procedurave te menaxhimit te percaktuara ne fushen ekonomike .	Drejtore (Ekonomist Finance)
3	Drejtoria e Projekteve te Huaja Projekti Hidrik dhe Kanalizimet e Tiranës se Madhe Koordinator Specialist Projekti Ujesjellesi dhe Ujrat e Perdorura, Shkoder dhe Koplik Koordinator Projekte me KFW Koordinator Projekte te Programit IPA Koordinator Specialist Projekti i Sherbimeve Esenciale Koordinator Projekti i Ujesjellesit te Vlores Specialist	Mbikqyrje dhe monitorimi i veprimtarise se projekteve me Financim te huaj brenda dhe jashte Drejtorise se Pergjithshme te Ujesjelles Kanalizime . Monitoron dhe koordinon pregatitjen e mareveshjeve Financiare me donator te huaj . Koordinimi me Drejtorine Teknike per Organizimin e KT , shqyrtimi i Dokumentacionit dhe depozitii i tyre ne arshive.	Inxhinjer (Ndertim)

4	Drejtoria e Monitorimit te Projekteve dhe Sh.a.UK-ve Drejtor Sektori i Monitorimit te Projekteve dhe Faqes se Internetit Pergjegjes Sektori Specialist Sektori i Monitorimit te Sh.a.UK-ve Pergjegjes Sektori Specialist Specialist Specialist	Te ndjeke dhe te analizojer ecurine e ndermarrjeve te Ujesjelles Kanalizimeve dhe te percaktoje rruget per permiresimin e treguesve ekonomike dhe financiare si dhe te propozije per ndryshime organizative te tyre Mer informacionin dhe raportin per ecurine e zbatimit te projekteve me donator te huaj Organizon dhe ndjek procesin e publikimit ne internet te te gjithë informacionit te DPUK	Ekonomist (Finance)
---	--	--	------------------------------------

Elanush
per Zbatues
08/05/09
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kryeministri

U R D H Ë R

Nr. 65, datë 6.5.2009

PËR

MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS
SË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil", dhe të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",


U R D H Ë R O J:

1. Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjiellës-Kanalizimeve të jetë sipas skemës nr.1, që i bashkëlidhet këtij urdhri.
2. Organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjiellës-Kanalizimeve të jetë sipas skemës nr.2, që i bashkëlidhet këtij urdhri.
3. Numri i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjiellës-Kanalizimeve të jetë, gjithsej, 35 veta.

4. Urdhri nr.254, datë 1.11.2006, i Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetës-Kanalizimeve", i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Sali Berisha', written over a horizontal line.

SALI BERISHA

ORGANIKA E DREJTORISE SE PERGJITHSHEME UJESJELLES -KANALIZIME


POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
I. DREJTOR I PERGJITHSHEM		1
SEKRETAR		1
II. ZV/DREJTOR I PERGJITHSHEM/DREJTOR I PROJEKTEVE TE HUAJA		1
III. ZV/DREJTOR I PERGJITHSHEM		1
IV. DREJTORIA TEKNIKE		(8)
DREJTOR		1
SEKTORI I KONTROLLIT TE PROJEKTEVE DHE MAKINERI PAJISJE		(3)
PERGJEGJES SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	2
SEKTORI I PROGRAMIMIT		(2)
PERGJEGJES SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	1
SEKTORI JURIDIK DHE I PROKURIMEVE		(2)
PERGJEGJES SEKTORI	III-b	1
SPECIALIST	IV-a	1
V. DREJTORIA EKONOMIKE		(8)
DREJTOR		1
SEKTORI I FINANCES		(2)
PERGJEGJES SEKTORI	III-b	1
SPECIALIST	IV-a	1

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
SEKTORI I INVESTIMEVE		(2)
PERGJEGJES SEKTORI	III-b	1
SPECIALIST	IV-a	1
SEKTORI I BUREMEVE NJEREZORE DHE SHERBIMEVE		(3)
PERGJEGJES SEKTORI	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	1
SHOFER		1
VI. DREJTORIA E MONITORIMIT TE PROJEKTEVE DHE Sh.a. UK-ve		(7)
DREJTOR		1
SEKTORI I MONITORIMIT TE PROJEKTEVE		(2)
DHE I FAQES SE INTERNETIT		
PERGJEGJES SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	1
SEKTORI I MONITORIMIT TE Sh.a. UK-ve		(4)
PERGJEGJES SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	1
SPECIALIST	IV-b	2
VII. DREJTORIA E PROJEKTEVE TE HUAJA		(8)
PROJEKTI HIDRIK DHE KANALIZIMET E TIRANES SE MADHE		(2)
KOORDINATOR		1
SPECIALIST PROJEKTI		1
UJESJELLESI DHE UJERAT E PERDORURA, SHKODER DHE KOPLIK		(1)
KOORDINATOR		1
PROJEKTE ME KTW		(1)
KOORDINATOR		1
PROJEKTE TE PROGRAMIT IPA		(2)
KOORDINATOR		1
SPECIALIST PROJEKTI		1

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
PROJEKTI SHERBIMEVE ESENCIALE		(1)
KOORDINATOR		1
PROJEKTI I UJESJELLESIT TE VLORES		(1)
KOORDINATOR		1
PUNONJES GJITHSEJ		35

KRYEMINISTRI

SALI BERISHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE
TELEKOMUNIKACIONIT
MINISTRI

____/____2009

Nr. Prot. _____

URDHER

U
Nr. 93, Date 28.1.09

Per miratimin e Rregullores se Funkcionimit te Drejtorise se Pergjithshme te
Ujesjelles Kanalizimeve

Ne mbështetje te pikes 4, te nenit 102, te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, si dhe
Vendimit nr 532, date 20.08.1996, "Per ndryshim strukture dhe emerim kuadri":

URDHEROJ:

Miratimin e Rregullores "Per funksionimin e Drejtorise se Pergjithshme te Ujesjelles –
Kanalizimeve", bashkëlidhur këtij urdhri.

Ky urdhër hyn ne fuqi menjehere.

Sokol Olldashi

Minister

2. Ne 288
2. Kokesht
Drejtorise
per zbatim
fuqi 30/01/09



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PERGJITHSHME UJESJELLES KANALIZIME

RREGULLORE
E
FUNKSIONIMIT TË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË UJËSJELLES
KANALIZIME
(DPUK)

Tiranë, Maj 2009



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PERGJITHSHME UJESJELLES KANALIZIME

1. TE PERGJITHSHME.

Qellimi i Rregullores se Drejtorise se Pergjithshme Ujesjelles Kanalizime eshte organizimi, menaxhimi dhe harmonizimi i punes mes Drejtorive dhe Sektoreve brenda saj si dhe Drejtorive te Ministrise se Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, duke percaktuar te drejta dhe detyrime te ndersjellta per realizimin e objektivave ne administrimin e sistemeve te furnizimit me uje, kanalizimeve te ujrave te perdorura dhe te trajtimit te tyre.

Kjo rregullore percakton organizimin, misionin, objektin e veprimtarise si dhe detyrat funksionale te Drejtorit te Pergjithshem, Nendrejtorave te Pergjithshem, Drejtoreve te Drejtorive, Pergjegjesave te Sektoreve dhe specialisteve qe perbejne stafin e Drejtorise se Pergjithshme te Ujesjelles Kanalizimeve (DPUK).

2. MENYRA E FUNKSIONIMIT.

Drejtoria e Pergjithshme Ujesjelles Kanalizimeve eshte institucion i krijuar ne zbatim te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 532, date 20.08.1996, "Per ndryshim strukture dhe emerim kuadri". DPUK eshte person juridik, buxhetor, me qender ne Tirane, qe funksionon si institucion me cikël menaxherial te mbyllur, ne varesi te Ministrit te Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

3. OBJEKTI I VEPRIMTARISE.

3.1. ROLI DHE MISIONI:

Drejtoria e Pergjithshme Ujesjelles Kanalizimeve eshte i vetmi organ shteteror i specializuar ne fushen e furnizimit me uje te pijshem, kanalizimeve te ujrave te zeza dhe te bardha si dhe trajtimit te tyre (infrastruktures ujore). Ajo mbeshtet teknikisht politikat e Ministrise se Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit ne kete fushe ne perputhje me legjislacionin dhe politikat e Qeverise te percaktuara ne strategjite sektoriale.

Roli i DPUK ne fushen e veprimtarise se saj eshte qe te realizoje nepermjet autoritetit te saj ligjor dhe teknik, koordinimin dhe monitorimin e aktivitetit per sigurimin e furnizimit me uje, kanalizimeve te ujrave te perdorura dhe trajtimit te tyre per te gjithe popullsine e vendit, ne bashkepunim me pushtetet vendore dhe subjektet e menaxhimit te infrastruktures ujore.

Per te realizuar misionin e saj ne mbeshtetje te kuadrit te pergjithshem te veprimtarise se Ministrise, DPUK - ja:

- ♦ Harton kuadrin strategjik per zhvillimin dhe menaxhimin e sektorit të ujesjelles kanalizimeve ne vendin tone;
- ♦ Propozon planifikimin vjetor te investimeve nga Buxheti i Shtetit duke u mbeshtetur ne nevojat qe paraqesin Njesite e Qeverisjes Vendore/Sh.a Ujesjelles Kanalizime dhe e paraqet per aprovim Ministrit te Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;
- ♦ Mbeshtet me financim, nepermjet Ministrise se Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, nevojat per kosto lokale, takse doganore dhe rimbursim TVSH-je kontratat e miratuara te financuara nga donatoret e huaj.
- ♦ Propozon standartet dhe specifikimet teknike per ujesjellesa dhe kanalizime dhe i dergon per miratim ne organet perkatese;
- ♦ Harton dhe pergatit projekt aktet ligjore dhe nenligjore qe kane te bejne me fushen e administrimit dhe te shperndarjes se ujit te pijshem, largimit te organizuar dhe trajtimin e ujrave te perdorura;
- ♦ Organizon dhe drejton punen per evidentimin e projekteve te reja ne sektorin e infrastruktures ujore;
- ♦ Ndjek reformat qe ndermerren nga Qeveria per te permiresuar menaxhimin, operimin si dhe te permiresimit te treguesve te sektorit duke mbeshtetur Njesite e Qeverisjes Vendore dhe subjektet e menaxhimit te infrastruktures ujore;
- ♦ Pergatit dokumentacionin dhe ndjek ecurine e zhvillimit te formave alternative te menaxhimit ne sektorin e Ujesjelles Kanalizimeve;
- ♦ Bashkepunon me institucione qendrore dhe vendore, donatore te huaj, shoqata joqeveritare vendase apo te huaja, te interesuara per zhvillimin e sektorit te infrastruktures ujore.
- ♦ Bashkepunon me Sekretariatit e Keshillit Kombetar te Ujit dhe Agjensite e Baseneve Ujore per nje menaxhim efikas te burimeve ujore sidomos per ato qe shfrytezohen per uje te pijshem;
- ♦ Organizon dhe drejton punen per prokurimin e investimeve (studime, projekte, mirembajtje, rehabilitime, ndertime te reja) sipas legjislacionit ne fuqi;
- ♦ Ndjek ecurine e projekteve me donatore te huaj nepermjet njesive te zbatimit te projekteve ne vartesi te saj dhe pergjigjet per ecurine e tyre. Rakordon me Drejtorine e Menaxhimit te Projekteve ne Ministrine e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit per projektet e infrastruktures ujore;
- ♦ Promovon dhe zbaton politikat ne sektorin e ujesjelles-kanalizimeve ne Shqiperi, nepermjet zbatimit me efektivitet te programit te monitorimit;
- ♦ Organizon dhe drejton mbledhjen e te dhenave nga te gjitha shoqerite ujesjelles-kanalizime qe operojne ne territorin e vendit, rishikon dhe vlereson te dhenat ne menyre periodike, ruan integritetin e tyre, zhvillon standarde realiste per vleresimin krahasues brenda sektorit, vezhgon progresin e ndermarrjeve te analizuara me qellim permiresimin e performances se tyre, te gjitha keto duke u bazuar ne treguesit e punes;
- ♦ Bashkepunon me Sektorin e Emergjencave Civile dhe institucionet e interesuara ne hartimin dhe zbatimin e programeve per sigurimin e objekteve te infrastruktures ujore;
- ♦ Ndjek dhe zhvillon marredheniet me organizatat dhe institucionet nderkombetare per sektorin e infrastruktures ujore;
- ♦ Organizon dhe drejton kualifikimin e personelit te DPUK dhe te ndermarrjeve te ujesjelles kanalizimeve nepermjet kurseve dhe seminareve qe zhvillohen brenda dhe jashte vendit;
- ♦ Ndjek dhe monitoron nivelin e sherbimit te furnizimit me uje dhe te largimit te ujrave te perdorura duke evidentuar problemet, duke dhene rruget e zgjidhjes se tyre duke informuar ne cdo rast Titullaret e Ministrise.

- ♦ Mundeson fushatat e sensibilizimit te publikut per te promovuar teknika te reja te bashkepunimit me komunitetin ne sherbim te zgjidhjes se problemeve te ndermarrjeve te ujesjelles kanalizimeve rritjen e nivelit te pageses se ujit nga konsumatorët, uljen e shperdorimeve te ujit te pijshem, etj.
- ♦ Ndjek ecurine e fushatave te organizuara nga Ndermarrjet dhe DPUK.

3.2. SISTEMI I INFORMACIONIT DHE KORESPONDENCES.

DPUK, organizon informacionin mbi gjendjen e Sistemit Ujesjelles Kanalizime nepermjet Shoqerive Anonime te Ujesjelles-Kanalizimeve.

Ne DPUK funksionon sistemi i panderprere i marrjes se informacionit nepermjet komunikimit te drejtperdrejte telefonik me drejtuesit e Shoqerive Anonime te Ujesjelles-Kanalizimeve dhe pushtetet vendore duke perpunuar informacionin dhe sipas rastit informon organet me te larta. Per problemet me te rendesishme te aktivitetit te saj, DPUK komunikon me Ministrite e institucionet e tjera nepermjet Ministrise se Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Komunikimi dhe shkembimi i informacionit kryhet nepermjet postes, faks, mjete elektronike, etj.

Per rastet e emergjencave per sektorin e ujesjelles kanalizimeve (permbytje, termete, epidemi, shkarje terrenesh etj) ne Drejtori funksionon sistemi operativ i informimit. Drejtori i Pergjithshem paraqet tek Titullari i Ministrise, sipas rastit gjendjen dhe vleresimin me masat per zgjidhje. Gjithe korespondenca e DPUK-se firmoset nga Drejtori i Pergjithshem dhe ne mungese te tij nga nje person i autorizuar prej tij.

3.3. SKEMA E ORGANIZIMIT E DPUK-se.

Drejtimi dhe funksionet e DPUK ushtrohen sipas strukture dhe skemes bashkengjitur.

Ne kuader te reformes se decentralizimit te sektorit te furnizimit me uje dhe te kanalizimeve, Drejtoria e Pergjithshme e Ujesjelles Kanalizimeve merr nje rol tjeter me te rendesishem, nga ofrues sherbimesh ne hartim politikash dhe strategjish sektoriale si dhe dhenie asistence teknike per te gjitha pushtetet vendore dhe ndermarrjet e ujesjelles kanalizimeve. Ajo do te vazhdoje te luaje nje rol te rendesishem ne monitorimin e sektorit te ujesjelles kanalizime, kontrollin e projekteve si dhe koordinimin e investimeve te financuara nga donatorët e huaj.

DPUK mban lidhje te ngushta me pushtetet vendore per shkembim informacioni per sektorin e ujesjelles kanalizimeve. Pushtetet vendore do te jene baza e sigurimit te te dhenave per ecurine e reformes ne kete sektor. Organizimi i analizave te perbashketa te punes per nivelin e sherbimit, politikat sociale specifike per sektorin e ujesjelles kanalizimeve, politikat tarifore, niveli i arketimeve, reduktimi i humbjeve, heqja e lidhjeve te paligjshme, program trajnimi per stafet e Sh.a UK etj do te jene subjekt i punes se perbashket i ketij institucioni me Ministrine e Brendshme (Pushtetit vendor dhe decentralizimit) si dhe me njesite e qeverisjes vendore.

4. ORGANIKA DHE STRUKTURA.

Numri i punonjesve ne organiken e DPUK dhe struktura organizative e saj miratohet nga Ministri i Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit me propozim te Drejtorit te Pergjithshem.

Nendrejtorat e Pergjithshem dhe Drejtoret e Drejtorive propozohen nga Drejtori i Pergjithshem dhe miratohen nga Ministri i Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

4.1. KESHILLI TEKNIK.

Keshilli Teknik (K.T.) eshte organ konsultativ i DPUK-se ne zgjidhjen e ceshtjeve tekniko-shkencore te sistemit te furnizimit me uje, kanalizimeve, trajtimit dhe pastrimit te tyre. Perberja e Keshillit Teknik duhet te reflektoje nivelin me te larte tekniko-profesional ne fushen e infrastruktures ujore. Keshilli Teknik perbehet nga 7 anetare dhe caktohen nga Drejtori i Pergjithshem.

Ne perberjen e anetareve te Keshillit Teknik, jane:

- Drejtori i Pergjithshem;
- Nendrejtori i Pergjithshem;
- Drejtoret e Drejtorive;
- Koordinatorët e Projekteve te Huaja;
- Te ftuar nga:
 - a. Institucione te tjera qe lidhen me studimin;
 - b. Subjektet e menaxhimit te infrastruktures ujore;
 - c. Perfaqesues nga Universiteti Politeknik i Tiranes, Fakulteti i Ndertimit (Dega Hidroteknike);
 - d. Perfaqesues nga Institutit i Ndertimit (IN);
 - e. Perfaqesues i Sekretariatit Teknik te Keshillit Kombetar te Ujit (SKTKKU);
 - f. Sektori Privat.

Drejtori i Pergjithshem me cilesine e Kryetarit te Keshillit Teknik drejton mbledhjet e Keshillit, te cilat organizohen sipas nevojave qe paraqiten nga Drejtoria Teknike. Njoftimi dhe materiali i mbledhjes pergatitet nga Sektori i Kontrollit te Projekteve dhe Makineri Pajisje i Drejtorise Teknike qe luan rolin e Sekretarise Teknike. Materiali i pergatitur nga Sekretaria Teknike u dorezohet anetareve te Keshillit Teknik, 5 dite perpara dites se mbledhjes sipas rendit te dites qe hartohet nga Nenkryetari dhe Sekretaria Teknike. Keshilli Teknik merr vendim, bazuar ne studimin e paraqitur dhe mendimet e anetareve.

4.2. DREJTORI I PERGJITHSHEM

Drejtori i Pergjithshem emerohet ne baze te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.173, date 07.03.2003 "Per emerimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra te drejtuesve te institucioneve ne vartesi te Keshillit te Ministrave, Kryeministrit ose Ministrit".

Drejtori i Pergjithshem organizon koordinon, drejton dhe pergjigjet per te gjithë veprimtarine e sistemimit te DPUK-se. Ai:

- Nxjerr urdhera dhe udhezime qe rregullojne veprimtarine e DPUK konform legjislacionit ne fuqi dhe ne perputhje me kete rregullore;
- Organizon mbledhje me drejtoret e drejtorive per zbatimin e detyrave te percaktuara ne planet javore, mujore dhe vjetore te miratuara nga ana e tij;
- Organizon cdo dite takime me Nendrejtorat e Pergjithshem per te percaktuar prioritetet e punes;

- Organizon analiza te punes se Drejtorive te DPUK-s dhe vete DPUK, tremujore, gjashtemujore dhe vjetore;
- Raporton me shkrim per veprimtarine vjetore te Drejtorise se Pergjithshme te Ujesjelles Kanalizimeve.
- Drejton Keshillin Teknik te DPUK
- Krijon Njesine dhe Komisionin e Prokurimit per objektet ku DPUK-ja eshte Autoritet Kontraktor, percaktuar nga Titullari i Ministrise.
- Miraton dhe mbikqyr procedurat e prokurimit te projekteve qe financohen nga buxheti i shtetit ne perputhje me legjislacionin e prokurimit publik.
- Perfaqeson DPUK ne veprimtarine e saj brenda dhe jashte vendit.
- Me autorizim te Ministrit te Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit nenshkruan kontrata me firmat fituese te tenderave nderkombetare.
- Propozon emerimin, largimin/shkarkimin e Nendrejtorit te Pergjithshem dhe Drejtoreve te Drejtorive, Ministrit te Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;
- Firmos kontrata me firmat fituese te tenderave per projekte te financuara nga Buxheti i Shtetit ku DPUK eshte ne rolin e Autoritetit Kontraktor.
- Miraton planet e punes se Drejtorise se Pergjithshme te Ujesjelles Kanalizimeve.
- Raporton ne menyre periodike ne Ministrine e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit per ecurine e punes ne DPUK si dhe merr per zbatim detyra te ngarkuara nga Sekretari i Pergjithshem, Zevendesministri dhe Ministri.
- Raporton me shkrim tek Sekretari i Pergjithshem per realizimin e detyrave ndaj Matrices vjetore te Ministrise.
- Konsultohet ne vazhdimesi me Kabinetin e Ministrit per veprimtarine e Drejtorise se Pergjithshme te Ujesjelles Kanalizimeve.
- Pergjigjet per problemet e menaxhimit te DPUK perpara Ministrit te Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

4.3. SEKRETARIA.

- Pergjigjet per pergatitjen e dokumentacioneve per titullarin;
- Mban evidencen e porosive qe merr prej Drejtorit te Pergjithshem dhe ndjek perfundimin e dhenies se pergjigjeve;
- Perpunon korrespondencen dhe materialet qe vijne ne adrese te Institucionit dhe eshte pergjegjese ne ndjekjen dhe mbajtjen e dokumentave per secilin nga sektoret/drejtorite;
- Ben njoftimet dhe organizon takimet dhe mbledhjet e tij;
- Mban protokollet e mbledhjeve.

4.4. NENDREJTORI I PERGJITHSHEM.

Nendrejtori i Pergjithshem, emerohet dhe lirohet/shkarkohet nga Ministri i Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit me propozim te Drejtorit te Pergjithshem.

- Mbulon dhe eshte pergjegjes per organizimin, koordinimin dhe drejtimin e punes ne fushat e veprimtarise se Drejtorise Ekonomike dhe Teknike;
- Eshte Nenkryetar e Keshillit Teknik te DPUK dhe ne mungese te Drejtorit te Pergjithshem drejton mbledhjet e Keshillit Teknik;
- Organizon analizat periodike me Drejtorine Ekonomike dhe Teknike;
- Propozon tek Drejtori i Pergjithshem per ndryshime ne organizimin e ketyre drejtorive ne rast se ai e shikon te nevojshme;

- Koordinon me Drejtorine Teknike per organizim e Keshillit Teknik per shqyrtimin e dokumentacionit te projekt-ideve/zbatimit per projektin perkates dhe siguron per depozitimin e tij ne Arshiven e DPUK-s;
- Drejton grupin teknik per hartimin e programit te punes te perballimit te situatave emergjente;
- Ne mungese dhe me porosi te Drejtorit te Pergjithshem te DPUK organizon dhe drejton punen dhe aktivitetin e DPUK;

4.5. DREJTORET E DREJTORIVE.

Drejtoret e Drejtorive, emerohen dhe lirohen/shkarkohen nga Ministri i Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit me propozim te Drejtorit te Pergjithshem.

- Drejtojne veprimtarine e drejtorive, raportojne dhe pergjigjen rregullisht, per te gjitha ceshtjet e rendesishme perpara Drejtorit te Pergjithshem dhe Nendrejtorit te Pergjithshem;
- Jane pergjegjes per organizimin dhe realizimin e puneve ne drejtorite e tyre bazuar ne detyrat e percaktuara per secilin nga sektoret si dhe per shfrytezimin e burimeve njerezore nen drejtimin e tyre;
- Informojne stafin sipas sektoreve perkates per objektivat e punes dhe per te gjitha ceshtjet e rendesishme per administrimin e drejtorise dhe sigurojne realizimin e tyre sipas afateve te percaktuara;
- Vendosin per ndarjen e puneve ne sektoret dhe strukturat qe drejtojne;
- Pergjigjen per perdorimin efikas te vlerave financiare dhe materiale ne ngarkim te sektoreve qe ata drejtojne, si dhe kontrollojne rregullisht zbatimin e parimeve administrative te administrimit te punes me kosto te ulet.

4.6. DREJTORIA TEKNIKE.

Drejtoria Teknike perbehet nga tre sektore:

1. Sektori i Kontrollit te Projekteve dhe Makineri Pajisje;
2. Sektori i Programimit;
3. Sektori Juridik dhe Prokurimeve.

4.6.1. SEKTORI I KONTROLLIT TE PROJEKTEVE DHE MAKINERI PAJISJE.

Ky sektor mbulon te gjithe aktivitetin teknik qe nga kontrolli teknik i dokumentacionit te projekteve, preventivave, kolaudimin e objekteve si dhe ndjekjen dhe azhurnimin e situates dhe gjendjen e makineri pajisjeve qe kane ne dispozicion ndermarrjet e ujesjelles kanalizimeve, ai:

- Kontrollon, vlereson dhe miraton te gjitha projektet e infrastruktures ujore te financuara nga buxheti i shtetit, donatoret e huaj si dhe ato te depozituara nga Njesite e Qeverisjes Vendore apo Sh.a Ujesjelles Kanalizime;
- Pergatit dosjet e projekt ideve/zbatimit se bashku me relacionin perkates per mbledhjet e Keshillit Teknik, si dhe merr masa qe konkluzionet e dala nga Keshilli Teknik te plotesohen e te kompletohen ne projektin e zbatimit;
Mban pergjegjesi per kontrollin dhe pergatitjen e dosjeve si dhe per organizimin e mbledhjeve te Keshillit Teknik;
- Ben vleresimin e projekteve te depozituara ne DPUK nga Nj.Q.V apo Sh.a. UK duke

- kryer verifikimi ne terren dhe vleresimin teknik te projektit ne teresine e tij;
- Krijon nje Data Base per te gjitha projektet e depozituara ne DPUK duke kryer azhornimet perkatese per projektet e reja qe dorezohen apo per ato objekte qe jane realizuar;
 - Pergatit apo kontrollon dhe miraton perpara fillimit te procedures se prokurimit te gjitha Detyrat e Projektimit te depozituara nga Nj.Q.V/Sh.a. UK per studime projektme;
 - Kontrollon preventivat e projekteve te zbatimit dhe ben azhornimin e tyre ne perputhje me manualet teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre te miratuara nga organet ligjvenses, ne perputhje me Legjislacionin per Prokurimin Publik, per projektet e financuara nga buxheti i shtetit dhe donatoret e huaj;
 - Kontrollon dhe miraton projekt-zbatimet si dhe preventivat e tyre perpara se te ^{AP}prokurohen;
 - Merr pjese ne grupet e kontrollit te investimeve te ngritura nga Drejtori i Pergjithshem dhe merr masa per korrigjimin e te metave teknike deri ne bllokimin e punimeve;
 - Azhornon ne menyre korente situaten e sektorit te furnizimit me uje dhe kanalizimeve;
 - Pergatit propozime per standarte dhe specifikime teknike per punimet ne sektorin e infrastruktures ujore dhe i paraqet ato ne Keshillin Teknik te DPUK per shqyrtim. Ato i percillen Drejtorise se Rregullave Teknike ne Ministri;
 - Bashkepunon me institute dhe organizma te tjere teknike dhe shkencore per probleme te perbashketa me fushen qe mbulon DPUK;
 - ^{AP}Studjon dhe identifikon nevojat per projekte te reja dhe percakton prioritetet e planifikimit dhe ndertimit te tyre;
 - ^{AP}Rakordon kerkesat e ardhura nga pushtetet vendore me projekt preventiva dhe dokumentacion ligjor sipas kerkesave te DPUK;
 - ^{AP}Pergatit programe trajnimi per specialistet e DPUK ne bashkepunim me organizma projektuese te huaja ose vendase, lidhur me teknologjite qe perdoren ne sektorin e furnizimit me uje dhe kanalizimeve etj;
 - ^{AP}Siguron akses te vazhdueshem me Arshiven e DPUK, konsulton projektet dhe i depoziton ato sipas periodikut pas miratimit te tyre. Dosjet duhet te kene te inventarizuar te gjithe dokumentacionin qe ekziston si dhe raportin teknik per miratimin e projektit;
 - ^{AP}Kontrollon projektet e paraqitura ne DPUK ne komponentin elektrik dhe te pajisjeve.
 - Ben studime per planifikimin e makineri pajisjeve per sektorin perkates ne shkalle vendi;
 - ^{AP}Ben vleresimin e energjise elektrike per te gjitha stacionet e pompimit qe jane ne administrim te ndermarjeve te ujesjellesit duke evidentuar problematikat e mundshme si dhe rruget e zgjidhjes se tyre;
 - ^{AP}Ndjek problemet e furnizimit me energji elektrike te objekteve te furnizimit me uje dhe te kanalizimeve (stacionet e pompimit, veprat e trajtimit) dhe propozon masat dhe jep udhezime per funksionimin normal te tyre.

4.6.2. SEKTORI I PROGRAMIMIT.

Ky sektor kryen planifikimin e investimeve per sektorin bazuar ne projektet e depozituara ne DPUK, prioritetet e te ciles jane:

- Programon fondet e nevojshme ne perputhje me kuotat e vena ne dispozicion nga Qeveria per investimet ne sektorin ujesjelles kanalizime;
- Planifikon dhe harton programin e investimeve ne sektorin ujesjelles kanalizime, ne bashkepunim me Sektorin e Kontrollit te Projekteve dhe Makineri Pajisje dhe me Sektorin e Investimeve;
- Pregatit dhe justifikon ndryshimet e kerkuar ne planin e investimeve apo qe lindin si

- domosdoshmeri gjate vitit bazuar ne prioritetet dhe nevojat e dala;
- Pergatit dhe ndjek te gjitha procedurat e celjeve te investimeve dhe regjistron per raportime periodike ecurine e tyre;
- Ben ndarjen e fondeve te objekteve per Ndertim Montim, Mbikqyrje dhe Kolaudim perpara fillimit te procedurave te prokurimit;
- Vlereson prioritetet e sektorit duke i perfshire ato ne buxhetin afatmesem dhe ate vjetor;
- Identifikon nevojat per studime projektme sipas prioriteteve duke propozuar dhe planifikimin e fondeve te nevojshme;
- Kryen planifikimin e fondeve te nevojshme per TVSH/TD dhe Kosto Lokale per projektet me financim te huaj bazuar ne kerkesat e Drejtorise se Projekteve te Huaja dhe te Marreveshjeve te projekteve respektive;
- Ploteson fishe projektet per objektet qe kerkojne financim;
- Mbeshtet Sektorin e Kontrollit te Projekteve dhe Makineri Pajisje me kontrollin e projekteve te depozituara ne DPUK.

4.6.3. SEKTORI JURIDIK DHE PROKURIMEVE.

Sektori e kryen funksionin e tij ne mbeshtetje te legjislacionit shqiptar. Ai eshte e konceptuar dhe kryen funksionin mbeshtetur ne ciklin e punes se DPUK, ai:

- Ndhmon dhe keshillon drejtorite ne diskutimin dhe pergatitjen e projektakteve dhe akteve te tjera nenligjore te fushes qe mbulon DPUK -ja;
- Jep mendime per persosjen e legjislacionit te infrastruktures ujore;
- Harton, mbikqyr dhe bashkepunon per hartimin e dokumentave standarte per prokurimet, sigurimin e te dhenave te nevojshme per prokurimet publike nga strukturat perkatese ne institucion mbeshtetur ne legjislacionin perkates;
- Harton dhe dergon njoftimet per botim ne Buletinin e Agjencise se Prokurimit Publik brenda afateve kohore;
- Harton urdherat e prokurimit publik;
- Ruan fshehtesine e cdo informacioni qe ka te beje me procedurat e prokurimit;
- Eshte i pranishem (ne njesi prokurimi) gjate te gjitha punes se komisionit te vleresimit dhe mund te jape mendime;
- Ndjek dhe mban te gjitha proces-verbalet e punes se komisionit te cilat duhet te jene te firmosura nga te gjitha anetaret e komisionit te vleresimit, si dhe te mbledhe dhe sistemoje ne dosje te vecanta te gjitha dokumentacionin e tenderave;
- Zbaton procedurat e prokurimit ne perputhje me legjislacionin ne fuqi per prokurimet publike, propozon per pezullim procedure prokurimi kur sheh shkelje te ketij legjislacion;
- Harton dhe mbikqyr procedurat e lidhjes se kontratave me kandidatet fitues dhe jep informacion kur sheh shkelje te elementeve te kontrates;
- Ka te drejten te propozoje pezullimin e kontrates kur sheh shkelje te saj;
- Ndhmon, sqaron dhe i jep mendim juridik dhe mbeshtetje ligjore, drejtorive dhe sektoreve per problemet qe atyre u dalin gjate veprimtarise se tyre;
- Ne kuadrin e njohjes se legjislacionit zberthen aktet ligjore e nenligjore duke njohur punonjesit e DPUK me specifiken e tyre ne kuadrin e veprimtarise praktike;
- Shqyrton dhe jep mendime per projektet aktet qe vijne nga institucione te tjera ne fusha te ndryshme te legjislacionit;
- Sqaron nga ana ligjore qytetaret dhe punonjesit e DPUK per paqartesite qe kane ne lidhje me legjislacionin qe lidhet me veprimtarine e DPUK ne sektorin e ujesjelles kanalizimeve;
- Perfaqeson DPUK me autorizim te titullarit ne te gjitha nivelet e gjyqesorit shqiptar.

4.7. DREJTORIA EKONOMIKE.

Drejtoria Ekonomike perbehet nga tre sektore:

1. Sektori i Finances;
2. Sektori i Investimeve;
3. Sektori i Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve.

4.7.1. SEKTORI I FINANCES.

Detyra e ketij sektori eshte te beje programimin dhe ndjekjen e fondeve operative te DPUK.
Gjithashtu ai:

- Organizon dhe drejton punen per zbatimin e akteve ligjore dhe nenligjore ne fushen e finances, kontabilitetit dhe pagave. Pergatit rregullore per zbatimin e tyre korrekt ne fushen e finances dhe kontabilitetit;
- Mban kontabilitetin e DPUK dhe harton bilancin financiar mbi aktivitetin e DPUK sipas afateve te percaktuara ne legjislacionin ne fuqi. Rakordon me Ministrine e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit per te gjithë treguesit e buxhetit.
- Pergjigjet per menaxhimin e fondeve si ato te Buxhetit te Shtetit ashtu dhe per te ardhurat;
- Harton Projekt Buxhetin dhe programet ne fushen financiare, ndjek dhe raporton cdo 2 mujor zbatimin e tyre;
- Mban Librin e Thesarit, mban Ditarin e Bankes, ditarin e veprimeve te ndryshme mban Librin e Madh, ben rakordimet per cdo objekt me Thesarin. Pergatit te dhenat mbi realizimin e Buxhetit per vitin financiar te mbyllur dhe llogarite vjetore (te pasurise);
- Merr pjese ne hartimin dhe shqyrtimin e programeve te zhvillimit ekonomik e shoqeror duke vleresuar ne menyre te vecante aspektet financiare te ketyre programeve;
- Ndjek punen per studimin, vendosjen dhe arketimin e te ardhurave te tjera qe hyjne ne perberje te te ardhurave te buxhetit dhe rakordon ne degen e buxhetit;
- Ploteson dhe kryen te gjitha veprimet per pagesat brenda afatit me thesarin. Rakordon me projektet e huaja per pagesat e kryera nga fondi i Buxhetit Shtetit;
- Rakordon dhe likujdon ne kohen e duhur te gjitha detyrimet me te tretet;
- Merr pjese ne blerjet e vogla sipas ligjit ;
- - Ben sistemimin e dokumentave te bankes dhe i regjistron ato ne ditar cdo muaj.
- - Ndjek veprimet e arkës dhe i kontabilizon ato;
- - Ndjek veprimet e magazines dhe i kontabilizon ato;
- Mban ditarin e pagave;
- Harton listepagesat e personelit dhe pergjigjet per saktesimin ne zbatimin e Ligjit per pagat e personelit dhe i kontabilizon ato. Mban analizen e llogarive te paguara;
- Harton listepagesat per sigurimet shoqerore dhe sigurimet suplementare sipas rakordimeve ne kohe me Sigurimet Shoqerore dhe kryen cdo veprim lidhur me sigurimet shoqerore;
- Harton evidencen e fuqise punetore dhe fondin e pagave;
- Merr pjese ne plotesimin e dokumentacionit per pagesat e thesarit dhe mbylljen e thesarit.

4.7.2. SEKTORI I INVESTIMEVE.

Detyra e ketij sektori eshte te beje ndjekjen e fondeve te investimeve ne fushen e Ujesjelles-Kanalizimeve per objektet e menaxhuara nga DPUK dhe organet e pushtetit lokal.

- Koordinon punen me sektorin perkates te Drejtorise Teknike per programimin e investimeve si dhe ndjekjen e te gjitha problemeve gjate procesit te menaxhimit te tyre nga DPUK ose Organet e Pushtetit Lokal.
- Mban kontakte te regullta me Drejtorite perkatese te Ministrise per realizimin e investimeve dhe ndryshimet eventuale gjate vitit;
- Ben ndjekjen mujore te realizimit te investimeve ne nivel vendi dhe rakordon me Ministrine e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;
- Pergatit dokumentacionin per pagesat e kontraktoreve kundrejt situacioneve pasi i kontrollon ato dhe ben rakordin sipas preventivit baze;
- Ndjek dhe mban pergjegjesi per ecurine e te gjitha kontratave ku DPUK-eshte Autoritet Kontraktor;
- Ndjek realizimin e kontratave bazuar ne raportimet e Mbikqyresve si dhe te inspektimeve te kryera ne terren;
- Sistemon te gjithe dokumentacionin dhe korespondencen per kontratat dhe mban pergjegjesi per ruajtjen e tij;
- Ndjek ecurine e disbursimeve nga DPUK dhe organet e pushtetit lokal;
- Ndjek dhe realizon te gjitha kostot lokale dhe TVSh per projektet me donatore te Huaj si dhe propozon per ndryshime ne planin e tyre sipas ecurise se projekteve;
- Bashkepunon me Drejtorine Teknike dhe merr prej saj te dhena per objekte te ndryshme;
- Bashkepunon me Sektorin e Kontrollit te Projekteve dhe Makineri Pajisje dhe merr prej saj te dhena per projekte - preventivat e kontratave dhe ndryshimet e mundshme;
- Kryen kontrole ne bashkepunim me Drejtorine Teknike, Sektorin e Kontrollit te Projekteve dhe Makineri Pajisje, ne prezence te mbikqyresit te punimeve duke mbajtur akt kontrole per punimet e pjesshme dhe perfundimtare;
- Kur konstaton shkelje te kushteve teknike dhe per mos zbatimin e detyrave te lena me shkrim, gurpi i kontrollit ka te drejte te pezulloje punimet duke mbajtur procesverbal perkates dhe ti propozoje me shkrim per masat e nevojshme Drejtorit te Pergjithshem;
- Ne perfundim te punimeve te zbatimit ne objekte merr ne dorezim nga Mbikqyresi i Punimeve dokumentacionin origjinal te mbajtur prej tij gjate periudhes se mbikqyrjes se punimeve dhe ate te mbajtur nga Sipermarresi. Ky dokumentacion i vihet ne dispozicion Grupit te Kolaudimit (i cili ngrihet me Urdher te Drejtorit te Pergjithshem).

4.7.3. SEKTORI I BURIMEVE NJEREZORE DHE SHERBIMEVE.

Ky sektor duhet te beje zbatimin e organinogrames se miratuar, trajtimin e procedurave te plotesimit dhe permiresimit te pajisjeve te punes, kujdesit per mbarevajtjen e sherbimeve te ndryshme si sistemi i telekomunikacionit, prokurimi i materialeve dhe mbajtja e inventareve, problemet e sigurimit, protokollimit dhe arshivimit, posten, biblioteken, pastrim dhe mirembatje te nderteses dhe zyrave, automjeteve etj, ai:

- Pergjigjet per mbarevajtjen e evidences per regjistrimet personale, te cilat perfshijne te dhenat dhe informacionin e duhur lidhur me personelin e DPUK-se;

- Pergjithshme*
- Ploteson dhe ruan dosjet e personelit;
 - Realizon ndjekjen e zbatimit te politikës se shtetit per pagat e punes;
 - Pergatit, ndjek dhe verifikon rregullat e pergjithshme te veprimtarise se punonjesve, te mirembajtjes se objektit, te kriterëve per zbatimin e disiplines ne pune;
 - Regjistron dhe kontrollon sherbimet e punonjesve;
 - Miremban dhe kontrollon te gjithë rrjetin kompjuterik;
 - Pergjigjet per gjithë sistemin elektrik te godines;
 - Kontrollon levizjet e automjeteve, harton kerkesat per karburant te tyre dhe ndjek ne vazhdimësi konsumin e tij; *Holimi*
 - Kontrollon dhe arshivon dokumentat e automjeteve, flete-udhëtimet e shofereve, proces verbalet e automjeteve; *Holimi*
 - Regjistron cdo dokument qe hyn ne DPUK, ben shperndarjen e tyre ne Drejtorite perkatese (pasi siglohen nga Drejtori i Pergjithshem);
 - Vulos dhe regjistron dokumentat e firmosura nga Drejtori i Pergjithshem ose nga personi i ngarkuar (ne mungese dhe me porosi te Drejtorit te Pergjithshem);
 - Arshivon dokumentat e DPUK-se;
 - Ruan sekretin e dokumentit te hyre ne arshive. *Hole*

4.8. NENDREJTOR I PERGJITHSHEM DHE DREJTOR I PROJEKTEVE TE HUAJA.

- Mbikqyr dhe monitoron veprimtarine e projekteve me financim te huaj brenda dhe jashte Drejtorise se Pergjithshme te Ujesjelles Kanalizimeve;
- Monitoron dhe koordinon pregatitjen e marreveshjeve financiare me donatore te huaj;
- Shqyrton dhe kontrollon dokumentacionin e pagesave te projekteve te financuara nga donatoret e huaj apo nga buxheti i shtetit (TVSH/TD/Kosto Lokale);
- Asiston dhe koordinon takimet me donatoret e huaj dhe firmat zbatuese per problematika te vecanta qe mund te lindin gjate zbatimit te projekteve;
- Koordinon si pike kontakti per pregatitjen e projekteve me bashkefinancim te huaj;
- Organizon analizat periodike me Njesite e Zbatimit te Projekteve;
- Propozon tek Drejtori i Pergjithshem per ndryshime ne organizimin e Njesive te Zbatimit ne rast se ai e shikon te nevojshme;
- Koordinon me Drejtorine Teknike per organizim e Keshillit Teknik per shqyrtimin e dokumentacionit te projekt-ideve per projektin perkates dhe siguron per depozitim te tij ne Arshiven e DPUK-s;
- Ne mungese dhe me porosi te Drejtorit te Pergjithshem te DPUK organizon dhe drejton punen dhe aktivitetin e DPUK.

4.9. DREJTORIA E MONITORIMIT TE PROJEKTEVE Sh.a. U.K.

Kjo drejtori perbehet nga dy sektore:

1. Sektori i Monitorimit te Projekteve dhe Faqes se Internetit;
2. Sektori i Monitorimit te Sh.a. Ujesjelles Kanalizime.

4.9.1. SEKTORI I MONITORIMIT TE PROJEKTEVE DHE FAQES SE INTERNETIT.

- Merr informacionin e nevojshem dhe raporton prane Nendrejtorit te Pergjithshem per

- donatoret e huaj per ecurine e zbatimit te projekteve;
- Bashkepunon me strukturat e DPUK per probleme te ndryshme qe lindin gjate zbatimit te projekteve;
 - Rakordon me Ministrine e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit per ecurine e projekteve me donatoret e huaj;
 - Merr pjese ne organizime, grupe pune, kontrolli, takime etj;
 - Propozon Nendrejtorit te Pergjithshem per masa dhe nderhyrje te karakterit teknik, organizativ dhe administrativ;
 - Merr pjese aktive ne takimet me donatoret dhe jep mendime per shkallen e prioritetit te investimeve ne rajone te ndryshme te vendit;
 - Bashkepunon me te gjitha njesite e projekteve dhe agjensive dhe siguron ne DPUK kopje te plota te dokumentacionit kryesor te projekteve;
 - Krijon nje Data Base per projektet me financim te huaj si dhe kryen azhurnimin e saj me projektet e reja apo qe jane realizuar;
 - Bashkepunon me Drejtorine Teknike per njohjen sa me te mire te gjendjes se infrastruktures ujore dhe pergatit projekt propozime perkatese per financim nga donatoret e huaj;
 - Propozon dhe eshte pergjegjese per strukturimin dhe mbarevajtjen e faqes se internetit te DPUK-se;
 - Organizon dhe ndjek procesin e publikimit ne internet te te gjithe informacionit te DPUK, miremban ate dhe rifreskon rregullisht pas miratimit nga Drejtori i Pergjithshem;
 - Koordinon punen e saj me Drejtorine e Koordinimit dhe Monitorimit te Projekteve ne Ministri;
 - Raporton te N/Drejtori i Pergjithshem dhe Drejtori i Projekteve te Huaja per ecurine e dibursimeve te kostove lokale dhe TVSH per projektet me Financim te Huaj.

4.9.2. SEKTORI I MONITORIMIT TE Sh.a. UJESJELLES KANALIZIME.

Sektori ka per detyre te ndjeke dhe te beje analize te ecurise se ndermarrjeve te ujesjelles kanalizimeve dhe te percaktoj rruget per permiresimin e treguesve ekonomike dhe financiare si dhe te propozoj per ndryshime organizative te tyre, gjithashtu ai:

- Ndjek dhe drejton te gjithe procesin e monitorimit te Indikatoreve dhe vete Ndermarrjeve te Ujesjelles-Kanalizime ne lidhje me performancen e tyre;
- Pergatit dhe drejton te gjitha seminarat e analizes se treguesve te punes per te gjithe sektorin;
- Pergatit rekomandime per zgjerimin e programit dhe rishikimin e treguesve qe monitorohen;
- Pergatit raporte me karakter tekniko-ekonomik dhe interpreton rezultatet e punes per cdo shoqeri ujesjelles-kanalizime si dhe per sektorin ne pergjithesi;
- Pergatit dhe kryen kurse trajnimi per stafin e shoqerive ujesjelles-kanalizimeve ne drejtim te mbajtjes, regjistrimit dhe raportimit te te dhenave ne perputhje me programin e monitorimit;
- Pergatit raporte 3-mujore dhe vjetore mbi situaten e Sh.a. UK si dhe i dergon keto raporte institucioneve qe kane lidhje me sektorin e UK, Sh.a. UK, Keshillave Mbikqyrese dhe Asamblese se Sh.a-ve;
- Ndjek ecurine e procesit te decentralizimit te sektorit te ujesjelles kanalizimeve si dhe rakordon veprimet me dikasteret e tjera per realizimin e reformes se decentralizimit.
- Planifikon dhe propozon modelin e shperndarjes se subvencioneve per ndermarrjet

- Ujesjelles-Kanalizime;
- Planifikon dhe shperndan subvencionet bazuar ne udhezimet ne fuqi;
- Ben trajtimin e problemeve ekonomike dhe financiare te ndermarrjeve te ujesjellesit dhe kanalizimeve ne kuadrin e monitorimit dhe krahasimit te treguesve te ndermarrjeve.

4.10. DREJTORIA E PROJEKTEVE TE HUAJA.

Kjo drejtori perbehet nga:

1. Projekti Hidrik dhe Kanalizimet e Tiranes se Madhe;
2. Ujesjellesi dhe Ujrat e Perdorura Shkoder dhe Koplik;
3. Projekte me KfW;
4. Projekte te Programit IPA;
5. Projekti i Sherbimeve Esenciale;
6. Projekti i Ujesjellesit te Vlores.

Koordinatorët e projekteve të huaja janë ngarkuar të menaxhojnë/koordinojnë fondet e akorduara nga donatorët e n dryshem për projektet respektive.

- Harton në bashkëpunim me Sh.a. Ujesjelles-Kanalizimeve dhe Njesite e Qeverisjes Vendore të zonave respektive ku do të zhvillohet projekti, programin e prioriteteve për investimet e planifikuara në kuadrin e kredise/grantit;
- Paraqet planin e investimeve për diskutim dhe miratim pranë Keshillit Teknik të DPUK-se dhe me pas i dërgon atë për miratim Donatorit;
- Dërgon në Drejtorinë Teknike dokumentacionin teknik të projektit për shqyrtim dhe miratim në Keshillin Teknik të DPUK të projekteve (ide/zbatimi);
- Ndjek nepermjet specialisteve (supervizore) cilesine e sherbimeve dhe punimeve per cdo objekt dhe raporton perpara Drejtorit te Pergjithshem dhe Nendrejtorit te Pergjithshem per ecurine e tyre;
- Realizon mbledhje mujore me Supervisorin për të analizuar ecurinë e punimeve dhe në rast të problemeve të konstatuara sugjeron rruget e zgjidhjes;
- Organizon brenda njesise dokumentacionin e korespondences sipas nje rregulli te miratuar nga Nendrejtori i Pergjithshem;
- Përgatit dokumentacionin e nevojshem për financim të kostove lokale, taksave doganore dhe rimbursimin e TVSH;
- Koordinon punën për zgjidhjen e problemeve me Nj.Q.V dhe Sh.a. UK;
- Paraqet planin e investimeve sipas financimeve të parashikuara në Marreveshjen midis dy vendeve;
- Merr pjesë në takimet e paleve në Marreveshje dhe i bën të njohur problemet që kanë dalë gjatë zbatimit të projektit;
- Mban lidhje me donatorin për problemet financiare të projektit;
- Bashkërendon me Nendrejtorin e Pergjithshem të projekteve me donatore të huaj për problematika të veçanta të projektit;
- Përgjigjet përpara Drejtorit të Pergjithshem për ecurinë e projektit.

4.11. Mbeshtetja me personel bazuar në Struktura të miratuar :

Drejtor i Pergjithshem
Sekretare e DP

1 (nje)

1 (nje)



N/Drejtor i Pergjithshem	1 (nje)
N/Drejtor i Pergjithshem dhe Drejtor i Projekteve te Huaja	1 (nje)
Drejtoria Teknike	8 (tete)
Drejtor	1 (nje)
Sektori i Kontrollit te Projekteve	3 (tre)
Dhe Makineri Pajisje	
Sektori i Programimit	2 (dy)
Sektori Juridik dhe Prokurimeve	2 (dy)
Drejtoria Ekonomike	8 (tete)
Drejtor	1 (nje)
Sektori Finances	2 (dy)
Sektori i Investimeve	2 (dy)
Sektori i Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve	3 (tre)
Drejtoria e Monitorimit te Projekteve dhe Ndermarrjeve Ujesjelles Kanalizime	7 (shtate)
Drejtor	1 (nje)
Sektori i Monitorimit te Projekteve dhe Fages se Internetit	2 (dy)
Sektori i Monitorimit te Indikatoreve dhe Ndermarrjeve UK	4(kater)
(Njesite e Zbatimit te Projekteve	8 (tete)
Projekti Hidrik dhe Kanalizimet e Tiranës së Madhe	2 (dy)
Ujesjellesi dhe Ujrat e Perdorura, Shkoder dhe Koplik	1 (nje)
Projekte me KfW	1 (nje)
Projekte te Programit IPA	2 (dy)
Projekti i Sherbimeve Esenciale	1 (nje)
Projekti i Ujesjellesit te Vlores	1 (nje)

4.12. Bashkengjitur eshte skema funksionale e DPUK.

4.13. Detyra te pergjithshme per personelin e DPUK-s.

Te gjithë punonjesit e DPUK:

1. Jane te detyruar te respektojne kete Rregullore;
2. Jane te detyruar te respektojne orarin e punes te percaktuar me akte ligjore apo nenligjore;
3. Jane te detyruar te hartojne plane pune javore, mujore dhe vjetore ne vartesi te udhezimeve qe japin drejtuesit e sektoreve, drejtorive apo te institucionit;
4. Jane te detyruar te raportojne per realizimin e detyrave te ngarkuara;
5. Ne te gjitha rastet kur punonjesit e institucionit marrin pjese ne takime, mbledhje etj brenda dhe jashte vendit jane te detyruar te raportojne me shkrim per aktivitetin qe kane ndjekur;
6. Jane te detyruar te ruajne te gjitha pajisjet e mjedisit ku punojne dhe ne pergjithesi ato te institucionit te tyre;

7. Jane e detyruar te respektojnë rregullat e mbrojtjes kundra zjarrit;
8. Jane te detyruar te ruajnë fshehtësinë e dokumentacionit që perpunojnë në zyrat e tyre dhe mbajnë përgjegjësi për publikimin e tyre;
9. Jane te detyruar që të mos përdorin për qëllime të tjera apo të demtojnë dokumenta të shkruara dhe të firmosura nga titullaret e institucionit;
10. Jane te detyruar të depozitojnë në arshiven e institucionit praktika të vleresuara të perfunduara drejtuesit të institucionit;
11. Jane te detyruar të përmbushin të gjitha detyrimet ligjore në marrëdhëniet në punë sipas Kodit të Punës;
12. Jane te detyruar të njoftojnë tek drejtuesit e tyre për të gjitha levizjet që bëjnë në kuader të përmbushjes së detyrave të tyre;
13. Jane te detyruar të vijnë në punë me paraqitje të rregullt, për të respektuar disiplinën në punë dhe etikën e institucionit.

Në rast mosparaqitje në punë në orarin e caktuar, largim nga detyra pa njoftuar ose mungesë pa arsye nga ana e drejtuesit të institucionit merren masa disiplinore deri në largim nga puna.

Të gjithë punonjësit e institucionit në përputhje me VKM nr. 511, datë 24.10.2002 "Për kohezgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore" dhe të VKM nr. 443, datë 26.06.2003 "Për miratimin e strukture dhe të niveleve të pagave të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme Ujesjelles Kanalizime, Institutit të Studimeve dhe Projektmeve Urbanistike dhe Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit", përfitojnë dhe gëzojnë të drejtën e pushimit dhe të shpërblimit.

Në raste situatash të vecanta, forcash madhore, Drejtori i Përgjithshëm i propozon Ministrin të Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit kalimin e institucionit në situatë emergjence. Në këto raste ai ka të drejtën e anulimit të programit të lejeve vjetore për të gjithë punonjësit e institucionit të tij.

Të gjithë punonjësit e institucionit gëzojnë të drejtën e barabartë për t'u trajnuar, për të marrë pjesë në seminare brenda dhe jashtë vendit, për t'u informuar rreth aktiviteteve që organizon DPUK-ja.

Të gjithë punonjësit e këtij institucioni respektojnë marrëdhëniet me median e shkruar dhe median elektronike vizive.

Të gjitha kontaktet e këtij institucioni me median, mbahen nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm me autorizim të veçantë të Ministrin të Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe gjithmone në prani të zedhenesit të MPPT&T.

Rregullorja hyn në fuqi pas miratimit me urdher të veçantë të Ministrin të Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Miraturuar me Urdhërin e Ministrin të Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit nr. ____ datë _____.2009.

STRUKTURA E DREJTORISE SE PERGJITHSHEME UJESJELLES KANALIZIME

